



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2020:136914

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643015

P.nr. 356/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurve: S. H., I. Z. dhe R. H., për shkak të veprës penale “Uzarpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2697/20, të datës 15.10.2020, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 30.04.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, përfaqësuesit e autorizuar të të dëmtuarit J. B. – N. R. av. Q. R., të pandehurit, si dhe përkthyeses gjyqësore Z. T., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. S. H., nga i ati R. dhe nëna E. e vajzërisë T., i lindur më ..., në fshatin K., me vendbanim në rr. “V. F.” në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i pesë (5) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I. Z., nga i ati R. dhe nëna E. e vajzërisë D., i lindur më ... në fshatin M., Komuna P., me vendbanim në rr. “V. F.” në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer katër (4) vite të shkollimit fillor, pensionist, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. R. H., nga i ati Sh. dhe nëna H. e vajzërisë D., i lindur më ... në P., me vendbanim në rr. “H. A.”, nr. ... dhe rr. “S.”, në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

1. I Pandehuri R. H.;

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Që nga viti 2016, në rrugën “V. F.” në P., i pandehuri R. H., me dashje dhe në vazhdimësi, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar dhe e mbanë të uzurpuar pronën e paluajjtshme, në sipërfaqe prej ... ari, në të cilën e kishte rrethuar me rrjetë teli me shtylla betoni, në zonën kadastrale në P., konkretisht në parcelën kadastrale me numër ... dhe listës poseduese me numër ..., pronë e të dëmtuarit J. B..

- me këtë ka kryer veprën penale “Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajjtshme” nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 320 par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 322 par. 1 dhe 5, 364, 367, 449 dhe 452 par. 1 të KPPRK-së, të pandehurin e:

GJYKON

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300) Euro, të cilën detyrohet ta paguajë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në shumën e përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Kërkesë pasurore juridike nuk është parashtruar.

Ndaj të pandehurve S. H. dhe I. Z., në kuptim të nenit 362 par. 1 nën-par. 1.3 të KPPRK-së;

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

2. I pandehuri S. H.;

II. Që nga viti 2002, në rrugën “V. F.” në P., i pandehuri S. H., me dashje dhe në vazhdimësi, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar dhe e mbanë të uzurpuar pronën e paluajjtshme, në sipërfaqe prej ... ari, në të cilën ka ndërtuar një shtëpi prej ... m² dhe një stallë bagëtish me

sipërfaqe prej ... m², në zonën kadastrale në P., konkretisht në parcelën kadastrale me numër ... dhe listës poseduese me numër ..., pronë e të dëmtuarit J. B..

3. I pandehuri I. Z.

III. Që nga viti 2002, në rrugën “V. F.” në P., i pandehuri I. Z., me dashje dhe në vazhdimësi, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar dhe e mbanë të uzurpuar pronën e paluajtshme, në sipërfaqe prej ... ari, në të cilën e kishte rrethuar me rrjetë teli me shtylla betoni dhe në vitin 2016 ka mbjellë ... copë fidanë të llojit qersh, mollë, kumbulla dhe dardhë, në zonën kadastrale në P., konkretisht në parcelën kadastrale me numër ... dhe listës poseduese me numër ..., pronë e të dëmtuarit J. B..

- me këtë të pandehurit kishin për të kryer veprën penale “Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

- Për shkak se ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.
- Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle për të pandehurit S. H. dhe I. Z., bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.2697/20, të datës 15.10.2020, kundër të pandehurve S. H., I. Z. dhe R. H., për shkak të veprës penale secili veç e veç “Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata në kuptim të nenit 280 të KPPRK-së, ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljes së çështjes për gjykim dhe leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurve në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPPRK-së, u është ofruar mundësia e deklarimit rreth fajësisë - të pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri R. H. në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, është penduar për veprimet e tij, asnjëherë më parë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, nga gjykata kërkoi që t’i shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Gjykata konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i njëjti, mori për bazë mendimin e prokurorit të shtetit, i cili u pajtua e pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase sipas tij pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore të KPPRK-së si dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykatës i propozoi që si të tillë ta aprovoj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të mendimit të prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërrmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen

të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Uzarpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, nuk ka qenë i gjykuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sa i përket të pandehurve S. H. dhe I. Z., në kuptim të nenit 362 par. 1 nën-par. 1.3 të KPPRK-së gjykata për të njëjtit refuzoi akuzën dhe vlerësoi se ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, për arsye se sipas parashtrës së datës 21.02.2023, dorëzuar në gjykatë nga përfaqësuesi i autorizuar të dëmtuarit J. B. av. Q. R., për heqjen dorë nga ndjekja penale për të pandehurit S. H. dhe I. Z., ngase sipas tij gabimisht ka menduar se të pandehurit në fjalë në mënyrë të kundërligjshme janë duke e shfrytëzuar pronën e të dëmtuarit, përveç këtij fakti, edhe N. R. përfaqësuesi i të dëmtuarit tani të ndjerë J. B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 29.03.2024, ka deklaruar se të pandehurit në fjalë i kanë pasur fqinjë me të cilët asnjëherë nuk kanë pasur probleme, paluajtshmëria në fjalë tani ka kaluar në pronësi të blerësit A. T. nga P., dhe pajtohet plotësisht në arsyet e theksuara në kërkesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit J. B. tani i ndjerë, ku me këtë të fundit ka qenë në raport familjar gjegjësisht djem të tezes.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim për të pandehurin R. H. është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor për të pandehurin R. H. është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për të pandehurit S. H. dhe I. Z. është marrë në bazë të nenit 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të neneve 242 dhe 364, 362 par. 1 nën-par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.356/2020, Datë 30.04.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.